



**BASHKIA
TIRANË**

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 28, datë 05.04.2017

PËR

**“KRIJIMIN E AGJENCISË PËR ADMINISTRIMIN E TREGJEVE (AAT) SI
INSTITUCION NË VARËSI TË BASHKISË TIRANË PËR ADMINISTRIMIN DHE
MENAXHIMIN E SHËRBIMEVE TË TREGJEVE PUBLIKË ”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1 shkronja “b”, nenit 28, nenit 54, shkronjat “ç”, dh” dhe nenit 55 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”(i ndryshuar); nenit 5 të Ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave të punës” (i ndryshuar); pika 17 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar); Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.76, datë 20.07.2001 për “Miratimin e Rregullores për Ndërtimin dhe Funksionimin e Tregjeve”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2016 për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 84, datë 29.12.2016 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I:

- 1.** Të miratojë krijimin e Agjencisë për Administrimin e Tregjeve, si institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës. Detyrat kryesore institucionale e funksionale të këtij institucioni do të jenë si më poshtë vijon:
 - a.** Të monitorojë organizimin dhe ecurinë e aktivitetit të përditshëm të tregtarëve të pajisur me lejen përkatëse në tregjet publike fikse dhe/ose të lëvizshme të Bashkisë së Tiranës, në përputhje me politikat e zhvillimit të tregjeve të hartuara prej saj, si edhe akteve të Kryetarit të Bashkisë Tiranë apo Këshillit Bashkiak të nxjerra për këtë qëllim;

- b. Të administrojë të gjitha problematikat e përditshme që lidhen me hapjen, mbylljen dhe mirëfunksionimin e tregjeve publike fikse dhe/ose të lëvizshme të Bashkisë së Tiranës;
 - c. Të administrojë të gjitha problematikat e përditshme që lidhen me mirëmbajtjen e zakonshme të infrastrukturës fizike të tregjeve publike fikse apo të lëvizshëm, si edhe kryerjen e shërbimit të pastrimit të përditshëm në hapësirën ku zhvillohen tregjet publike fikse dhe të lëvizshme;
 - d. Të planifikojë dhe ndjekë zbatimin e investimeve të nevojshme për përmirësimin e infrastrukturës së tregjeve publike fikse apo të lëvizshme në Bashkinë e Tiranës;
 - e. Të kryejë çfarëdo lloj aktiviteti tjetër që nuk bie në kundërshtim e që lidhet direkt apo indirekt me përmbushjen e detyrave institucionale e funksionale, si dhe të kryejë detyrat që i ngakohen njësisë së qeverisjes vendore në kuadër të hapjes dhe funksionimit të tregjeve dhe mbështetjes së biznesit të vogël;
2. Të miratojë stemën zyrtare të Agjencisë për Administrimin e Tregjeve, sipas Aneksit nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
 3. Të miratojë numrin e përgjithshëm të punonjësve të Agjencisë për Administrimin e Tregjeve të Bashkisë Tiranë 36 (tridhjetë e gjashtë) punonjës.
 4. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Agjencisë për Administrimin e Tregjeve të Bashkisë Tiranë, sipas Lidhjes së Pagave nr. 20 Aneksi nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
 5. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Aparatit të Bashkisë për vitin 2017, Programi i Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit.
 6. Në mbështetje të pikës 4 të këtij vendimi rekomandohet hartimi dhe miratimi i menjëhershëm i strukturës organizative dhe i rregullores së funksionimit të brendshëm të Agjencisë së Tregjeve të Bashkisë Tiranë.
 7. Në mbështetje të pikës 1 të këtij vendimi ngarkohet strukturat përgjegjëse të Bashkisë Tiranë dhe titullari i Agjencisë për Administrimin e Tregjeve të Bashkisë Tiranë, të identifikojnë, inventarizojnë dhe të ndjekin procedurat përkatëse për kalimin kapital të aseteve, ambienteve, pajisjeve të domosdoshme për përmbushjen e detyrave funksionale/institucionale të Agjencisë për Administrimin e Tregjeve të Bashkisë Tiranë.
 8. Në mbështetje të pikës 1 të këtij vendimi dhe pasi të jenë kryer veprimet e përcaktuara në pikën 7 të këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Tiranë të kryejë procedurat e nevojshme për kalimin kapital të aseteve, ambienteve, pajisjeve të domosdoshme për përmbushjen e detyrave funksionale/institucionale të Agjencisë për Administrimin e Tregjeve të Bashkisë Tiranë, duke nxjerrë urdhërat përkatës për këtë qëllim.
 9. Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 26.04.2004 për “Organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Kreu V, pika 3, shfuqizohet.
 10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe

Liçencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Agjencia për Administrimin e Tregjeve të Bashkisë Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

- 11.** Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

ANEKSI NR. 1

LOGO E PROPOZUARA PËR AGJENCINË



Lidhja Nr.20

Niveli i pagave për punonjësit e “Agjencisë për Administrimin e Tregjeve”

Nr	Pozicioni	Kategoria/ Klasa	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion
I	<i>Punonjes te sistemit me page grupi + shtese pozicioni</i>		1	2	3
1	Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1	2%	115 000
2	Drejtor Drejtorie	II-b	1	2%	90 000
3	Përgjegjës sektori	III-a	1	2%	75 000
5	Inspektor tregu, Specialist I	III-b	1/2	2%	55 000
6	Specialist II	IV-a	1/2/3	2%	44 000
II	<i>Punonjes te sistemit me klasa</i>	Klasa		Shtesa për vjetërsi	Paga bazë
7	Punonjës shërbimi, shofer	IV		1%	34 000
8	Pastrues, Roje	I		1%	30 000

1.Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr.20 për kategorinë I**, të jepet në masën **2%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet mbi **pagën e grupit**.

2.Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr.20 për kategorinë II**, të jepet në masën **1%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet mbi **pagën bazë të klasës së I**.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e arsimit të lartë:	
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë